



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:254845

Datë: 15.04.2022

Numri i dokumentit: 02923004

PKR.nr.188/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për krime të rënda, me Kryetarin e trupit gjykues Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta, në çështjen penale ndaj të pandehurit H.G. për shkak të veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll, apo posedim i paautorizuar i armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.236/21 të dt. 25.11.2021, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar me datë 07.04.2022, në prezencë të Prokurorit të shtetit Agron Galani dhe të pandehurit H.G. në të njëjtën ditë bie dhe shpall publikisht, ndërsa me dt.15.04.2022, përpiloi këtë merr këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri

H. G., i biri i dhe nënës, e gjinisë, i lindur me dt., në fsh. T. K. P., ku edhe banon, me l.nj.nr....., ka të kryer shkollën fillore, i papune, i martuar baba i tre fëmijëve, posedues i nr. tel....., i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. se Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Më parë ka siguruar e gjer me dt. 27.07.2021, rreth orës 22:00, në restorantin “...”, në fsh., K. Pejë, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët, mban në pronësi armë, në atë mënyrë që, pas pranimit të informatës së ishte shtënë me armë në një aheng familjar të organizuar po atë natë në restorantin në fjalë, policia kishin identifikuar dhe proceduar të njëjtin, i cili më pastaj kishte pranuar se kishte në pronësi një (1) pistoletë me gaz, e llojit “E. J.”, model: P.A.K, kalibër 9mm, me nr. serik: .. dhe një (1) karikator të të njëjtës pistoletë dhe e cila i është konfiskuar pasi për të njëjtën nuk posedonte leje përkatëse,

- me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366, par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 7,38,39,40,43,69, të KPRK-së, nenit 366 par.1 dhe 366 par. 3 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

Dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro, e të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 3 muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri i lartcekur dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimi me gjobë, gjykata do ta zëvendësoi me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

I pandehuri obligohet që në emër të, shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzet) euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I pandehuri obligohet që në emër të, taksës për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të pandehurit i konfiskohet një (1) pistoletë me gaz, e llojit "E. J.", model: P.A.K, kalibër 9mm, me nr. serik: ... dhe një (1) karikator të njëjtës pistoletë, të cilat pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi duhet të shkatërrohen.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për krime të rënda ka ngrit aktakuzë PP/I.nr.236/21 të dt. 25.11.2021, ndaj të pandehurit H.G. për shkak të veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll, apo posedim i paautorizuar i armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Konform nenit 245 të KPP-së me dt. 07.04.2022, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar prezentë kane qene Prokurori i Shtetit Agron Galani dhe i pandehuri Haxhi Gashi.

Gjykata konform dispozitave të nenit 246 par. 1 të KPP-së, e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri deklaroi se i ka kuptuar këto të drejta dhe se për mbrojtës nuk ka nevojë.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues, pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i është dhënë mundësia të pandehurit që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

I pandehuri, e ka pranuar fajësinë për veprën penale cila i vihet në barrë, ndihet i penduar, premton se më nuk do të përsëris vepra tjera penale.

Prokurori i shtetit është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit nga se shihet së është i vullnetshëm dhe në përputhje me shkresat e lëndës.

Gjyqtari i vetëm gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 246 dhe 248 par 1 të KPP-së, pasi që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: Raporti i policit T. K. #., i përpiluar nën nr. të rastit: .., dt. 27.07.2021; Raporti i policit N. Z. #., i përpiluar nën nr. të rastit: .., dt. 27.07.2021; Deklarata e të dyshuarit H. G., e dhënë pranë Stacionit Policor – Njësi i Hetimeve - Pejë, me dt. 27.07.2021; Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, i përpiluar nën nr. të rastit: .., dt. 27.07.2021; Fotografii nga vendi i ngjarjes dhe fotografi të mjetit të gjetur dhe të konfiskuar; Lista e dëshmimeve, e përpiluar nën nr. 418/2021, dt. 27.07.2021; Deklarata e të pandehurit H. G., e dhënë në Prokurori me dt. 24.11.2021; si dhe shkresat tjera të lëndës, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 248 par 4 të KPP-së ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit H.G. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll, apo posedim i paautorizuar i armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i parket fajësisë i pandehuri është i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe atë e ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 par.1 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurit, gjykata morri pranimin e fajësisë, shprehjen e pendimit për veprën e kryer, premtimin se ne te ardhmen nuk do te kryej vepra tjera penale, faktin se me pare nuk ka qene i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata nuk gjeti.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-se, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, duke u bazuar ne shpenzimet qe janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.2, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 366 par.3 të KPRK-së konfiskohen një (1) pistoletë me gaz, e llojit “E. J.”, model: P.A.K, kalibër 9mm, me nr. serik: ... dhe një (1) karikator të të njëjtës pistoletë, dhe e njëjta do të shkatërrohet pas plotfuqishmërisë e këtij aktgjykimi .

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për krime të rënda,
PKR.nr.188/21 dt. 15.04.2022.**

Bashkëpunëtore profesionale
Selvane Bukleta

Kryetari i trupit gjyqësor
Shaqë Curri

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.